



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 608/4 Prot

Tiranë, më 13.10.2022

**V E N D I M**

Nr.125, datë 13.10.2022

**Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet e kryera për daljen e vendimit nr. 2, datë 28.06.2022, “Për moskonfirmimin e nëpunësit civil”, të eprorit direkt dhe lirim nga shërbimi civil, të nëpunësit në periudhë prove \*\*\*\*\*.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga nëpunësi i K.Q. Dibër, \*\*\*\*\*,

**Vërej se:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një informacion prej nëpunësit \*\*\*\*\* i protokolluar me nr. 608 prot., datë 08.08.2022, nëpërmjet të cilit pretendohet se janë lejuar shkelje të ligjshmërisë, gjatë procedurës për marrjen prej eprorit direkt, të vendimit nr. 2, datë 28.06.2022, “Për moskonfirmimin e nëpunësit civil” e për rrjedhojë dhe lirim nga shërbimi civil.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë kësaj procedure, rezulton se nëpunësi në fjalë fillimisht, është emëruar si “Nëpunës civil në periudhë prove”, pas kryerjes së procedurës së rregullt të konkurrimit, në pozicionin e Specialistit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në Drejtorinë e Administrimit dhe

Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Dibër. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin administrativ nr. 01, datë 29.12.2020, të KQ, është vendosur moskonfirmimi i tij dhe lirimi nga detyra, për shkak të mosarritjes së rezultateve të pritshme në performancën e tij në punë dhe mosrealizimit me sukses të provimit të detyrueshëm në ASPA.

Duke mos qënë dakord me këtë akt, punonjësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Pasi ka marrë parasysh rrethanat e veçanta që kanë qënë evidente gjatë periudhës së provës, sidomos për shkak të pandemisë “Covid 19” dhe duke vlerësuar kryesisht faktin se palët, në këtë rast eprori dhe punonjësi, por edhe punonjësit e tjerë të institucionit të ngarkuar për të ndjekur ecurinë e nëpunësit në periudhë prove, në një pjesë të mirë kohe, nuk kanë qënë prezent në institucion, nëpërmjet vendimit nr. 1063 (80-2021-1065), dt. 12.04.2021, gjykata ka vendosur:

*-Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit \*\*\*\*\*.*

*-Të shfuqizojë vendimin e Këshillit të Qarkut Dibër nr.01 datë 29.2.2020.*

*-Të rikthejë paditësin si nëpunës civil në periudhë prove edhe për 6 muaj, dhe dhënien e pagës për këtë periudhë prove.*

Sa më sipër, në thelb, gjykata ka vendosur të shfuqizojë vendimin nr. 01, datë 29.02.2020 të Këshillit të Qarkut Dibër, për moskonfirmimin dhe të zgjasë periudhën e provës edhe për 6 muaj, duke urdhëruar njëherësh kthimin e nëpunësit në detyrën e mëparshme.

Në zbatim të vendimit të mësipërm gjyqësor, nga ana e titullarit të institucionit të Këshillit të Qarkut Dibër, është nxjerrë urdhëri nr. 76, datë 17.12.2021 “Për ngritjen e komisionit të brendshëm për shqyrtimin e fakteve në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor”. Komisioni ka konstatuar se pozicioni i mëparshëm i nëpunësit në fjalë, si Specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në DAMT, ishte zënë në mënyrë të përhershme, nga një nëpunës tjetër i marrë në punë nëpërmjet procedurës së rregullt të konkurrimit (nëpunësja \*\*\*\*\*), është emëruar në atë pozicion me aktin nr. 04, datë 01.03.2021, dhe më pas, në përfundim të periudhës së provës, me vendimin nr.02, datë 28.02.2022, është konfirmuar si nëpunës civil në atë pozicion).

Në bazë të nenit 56 pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicioni mbetet i paplotësuar, vetëm në rastin e pezullimit për një afat 3 mujor, si një detyrim i përcaktuar shprehimisht në ligj, për këtë arsye, ky veprim i institucionit vlerësohet i drejtë, pasi në kushtet kur pozicioni ishte i lirë për shkak të moskonfirmimit të nëpunësit të mëparshëm dhe kur numri i punonjësve të institucionit është i kufizuar, kishte lindur nevoja për plotësimin e menjëhershëm të tij.

Në rrethana të tilla, Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 76, datë 17.12.2021, ka propozuar që nëpunësi \*\*\*\*\* në zbatim të vendimit gjyqësor, të kalojë në një pozicion tjetër të nivelit ekzekutiv, që në atë kohë ishte i lirë, në atë të Specialistit të Menaxhimit të Burimeve

Njerëzore dhe Magazinës si nëpunës civil në periudhë prove, pranë sektorit Juridik dhe Projekteve. Për këtë emërim, nëpunësi në fjalë ka dhënë pëlqimin e tij, me shkresën, nr.46/24 prot. datë 05.01.2022, “*Aprovim Vendimi*”, që është bashkëlidhur dokumentacionit.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, duke analizuar edhe një herë në mënyrë të përmbledhur veprimet e njësisë përgjegjëse dhe të eprorit të drejtpërdrejtë për moskonfirmimin e nëpunësit \*\*\*\*\* , konstatohet se:

Gjykata Administrative e Shkallës së parë, duke marrë parasysht rrethanat, të cilat sipas saj kishin patur ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në performancën e dobët të nëpunësit gjatë periudhës së provës, ka vendosur ti japë edhe një herë mundësinë këtij nëpunësi të merret në provë në kushte normale, duke e shtyrë periudhën e provës për një periudhë 6 mujore.

Fakti që vendimi gjyqësor është i detyrueshëm ashtu siç është dhënë, bazuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 66/1 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, ishte detyrimi i institucionit të merrte masat e duhura për zbatimin e tij, gjë e cila duhej të shoqërohej edhe me nevojën e një zbatimi të plotë të vendimit në fjalë, për të realizuar qëllimin për të cilin ai ishte dhënë nga gjykata.

Kjo nënkupton që nga ana e njësisë përgjegjëse, të krijoheshin kushte për kryerjen e periudhës së plotë të provës dhe sidomos ti jepej edhe një herë mundësia nëpunësit të kryente detyrimin ligjor për dhënien e provimit në ASPA.

E shoqëruar kjo dhe me faktin se nëpunësi \*\*\*\*\* , nuk ishte kthyer në pozicionin për të cilin ai kishte shfaqur interes dhe kishte kryer konkurrimin, dilte edhe më qartë detyrimi për rregullimin e periudhës së provës në pozicionin e ri dhe plotësimin e kushteve për dhënien e provimit në shkollën e administratës publike, sipas kërkesave të Kreut IV, neni 1, të Vendimit nr. 138, datë 12.03.2014 “*Për rregullat e organizimit të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike, trajnimit e nëpunësve civilë, si dhe çdo individ tjetër jashtë shërbimit civil*”, i cili nënkupton dhënien e trajnimeve shtesë; një trajtim më të kujdesshëm nga nëpunësi mbikëqyrës i tij, gjithashtu edhe ti mundësonte kohë të përshtatej me pozicionin e ri, ku u caktua, duke qënë se natyra e punës nuk ishte e njëjtë.

Pra, nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se procedura e ndjekur për trajtimin e rastit të nëpunësit \*\*\*\*\* , është jo e rregullt.

Nisur nga përmbajtja e pikës 6, të kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në*

*katëgordinë ekzekutive”, vendimi në përfundim të periudhës së provës merret nga eprori direkt, bazuar në: “... a) rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA; b) vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore”.*

Nga verifikimi dhe trajtimi i tërësisë së rrethanave dhe dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatoj se kemi të bëjmë me një nëpunës, të cilit i është refuzuar konfirmimi në shërbimin civil, duke mos zbatuar deri në fund dispozitat e parashikuara në ligj si më sipër. Nga këqyrja e dokumentacionit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Dibër, rezulton se nëpunësi në fjalë, jo vetëm nuk ka kryer testimin në përfundim të ciklit të detyrueshëm nga ASPA, për arsye të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të vendimit të moskonfirmimit, por edhe periudha e provës në pozicionin e ri, ku u emërua në zbatim të vendimit gjyqësor, “*Specialist i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Magazinës*”, pozicioni i cili nuk kishte ngjashmëri me pozicionin për të cilin ai kishte konkurruar, nuk ka qënë e plotë. Do të ishte e drejtë dhe nuk kishte ndonjë pengesë ligjore që, pavarësisht kompleksitetit të marrëdhënies së lindur, periudha e provës të niste nga fillimi, duke respektuar të gjithë kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Nga ana tjetër, edhe nga pikpamja formale, aktet e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën 6 mujore të periudhës së zgjatur të provës, Janar-Qershor 2022, paraqiten me mangësi të ndryshme, si psh: zyrtari kundërfirmues (punonjësi *Haxhi Abazi*), nuk ka firmosur në aktin e vlerësimit, detyrim ky që rrjedh nga Kreu II, i Vendimit Nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, në të cilin përcaktohet se: 3) *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*; mungojnë komentet nga ana e zyrtarit raportues në formularin e vlerësimit dhe nuk rezulton të jetë marrë mendimi me shkrim i nëpunësit civil mbikëqyrës, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut VI të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgordinë ekzekutive*”, të cilat mund të shërbënin që, sipas pikave 3, 4 dhe 5, të kreut VI, të këtij vendimi, eprori direkt mund të vendoste konfirmimin ose moskonfirmimin e nëpunësit civil.

Pretendimi tjetër se *Përgjegjësja e Sektorit Juridik dhe Projekteve*, nëpunësja \*\*\*\*\*, është paraqitur dhe ka vepruar në cilësinë e eprorit direkt, në tejkalim të kompetencave të saj, nuk mund të pranohet. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është shprehur një herë në lidhje me këtë fenomen, me Vendimin nr. 89, datë 28.06.2022, duke konsideruar të rregullt paraqitjen e përgjegjësës së sektorit si epror i drejtpërdrejtë, në kushtet e strukturës organizative të shtrirë, të Këshillit të Qarkut Dibër.

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në përfundimin se procedura administrative e cila ka përfunduar me dhënien e vendimit nr. 2, datë 28.06.2022, “Për moskonfirmimin e nëpunësit civil”, është akt administrativ i paligjshëm dhe për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Dibër, duhet të vendosë anulimin e aktit të moskonfirmimit dhe lirimit nga shërbimi civil të nëpunësit në periudhë prove \*\*\*\*\*\*, duke i krijuar kushtet për përfundimin e periudhës së plotë të provës në pozicionin e fundit ku është caktuar dhe rifutjen në provimin e ASPA-s, duke patur parasysh plotësimin e gjithë kushteve, të cilat u përmendën në pjesën e arsyetuese të këtij vendimi.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara, në nenin 2 dhe 4, në pikën 1 të nenit 11, nenet 14 dhe 15, në shkronjën “a” të nenit 58, në pikën 1 të nenit 59, në pikën 4 të nenit 66/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikat 3, 4, 5, 6, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, në nenin 1, të Kreut IV, të Vendimit nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike, trajnimit e nëpunësve civilë, si dhe çdo individ tjetër jashtë shërbimit Civil” në pikën 3, të Kreut II, të Vendimit Nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, në nenin 109, pika “d” e ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neni 16, pika 8 dhe neni 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Njësia Përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Dibër që ka kompetencë të nxjerrë aktin, të vendosë anulimin e vendimit nr. 2, datë 28.06.2022, “Për moskonfirmimin e nëpunësit civil”, \*\*\*\*\*\*, dhe aktin e lirimit të tij nga detyra në pozicionin “Specialist i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Magazinës”, duke respektuar gjithë rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, siç u përmendën në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, duhet të krijojë kushtet e nevojshme për përfundimin e periudhës një vjeçare të provës në pozicionin aktual “Specialist i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Magazinës”, duke siguruar trajnime shtesë, një mbikëqyrje më të kujdesshme nga nëpunësi civil më i vjetër, si dhe të kryejë veprimet e nevojshme administrative për rifutjen e tij në provimin e ASPA-s.

3. Të njoftohet për këtë vendim Këshilli i Qarkut Dibër dhe ankuesi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**